

**Kontratë e përgjithshme për shitje/blerje të
menjëhershme të letrave me vlerë me detyrim për
riblerjen/shitjen e tyre
(Kontrata e përgjithshme repo)**

Lidhur në _____ më datë _____, midis:

1. _____, (në tekstin e mëposhtëm: pala kontraktuese)
2. _____, (në tekstin e mëposhtëm: pala kontraktuese)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

neni 1

Me këtë kontratë rregullohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, si dhe mënyra dhe kushtet në të cilat palët kontraktuese lidhin transaksionet për shitje/blerje të menjëhershme të letrave me vlerë me detyrim për riblerjen/shitjen e letrave me vlerë ose të letrave me vlerë ekuivalente (transaksionet repo).

Palë kontraktuese në këtë kontratë janë rezidentët në Republikën e Maqedonisë.

neni 2

Shprehjet e përdorura në këtë kontratë e kanë kuptimin si vijon:

“Çmimi i blerjes” është çmimi me të cilën, në datën e blerjes, blerësi blen letrat me vlerë që janë objekt i transaksionit nga shitësi.

“Data e blerjes” është data në të cilën blerësi blen letra me vlerë (letrat me vlerë të blera) nga shitësi.

“Data e riblerjes” është data në të cilën blerësi ia shet shitësit letrat me vlerë të blera ose ekuivalente.

“Diferenca e çmimeve” përcaktohet në çfarëdolloj ditë për kohëzgjatjen e transaksionit, me zbatimin e normës repo të interesit me çmimin e blerjes për numrin kalendarik të ditëve në periudhën prej datës së blerjes (duke përfshirë edhe atë datë) deri në datën e llogaritjes, ose deri në datën e riblerjes (duke përjashtuar edhe atë datë) në bazë të 360 ditëve në vit, sipas metodës proporcionale të llogaritjes.

“Norma repo e interesit” është norma e interesit që shërben për llogaritjen e diferencës në çmimet dhe mirret vesh ndërmjet palëve kontraktuese për transaksion të caktuar në përqindje, në nivel vjetor.

“Çmimi riblerjes” në ditë të caktuar është çmimi i barabartë me shumën e çmimit blerjes dhe diferencës së çmimit të llogaritur në atë ditë.

“Transaksioni i thirrjes” është transaksioni në të cilin data e riblerjes nuk përcaktohet në fillim të transaksionit dhe ai do të përcaktohet në mënyrë shtesë, me raportim me shkrim ku njëra palë kontraktuese ia dërgon palës tjetër kontraktuese. Nëse asnjë nga palët kontraktuese nuk dorëzon raportim me shkrim, do të konsiderohet se data e riblerjes ndodh në ditën e fundit kur është i lejuar tregtimi i këtyre letrave me vlerë, por jo më gjatë se një vit kalendarik pas datës së blerjes.

“Transaksioni me afat fiks” është transaksioni në të cilën data e riblerjes është caktuar gjatë fillimit të transaksionit.

“Letra me vlerë ekuivalente” janë letrat me vlerë që janë nga i njëjti emetues, i të njëjtit lloj dhe kanë të njëjtën vlerë tregu, gjegjësisht letrat me vlerë që për mbajtësin kanë të njëjtat të drejta si dhe letrat me vlerë që janë objekt i transaksionit. Letrat me vlerë ekuivalente mund të jenë edhe letra të tjera me vlerë që të dyja palët kontraktuese i kanë pranuar si letra me vlerë ekuivalente.

“Mbulimi” është shuma që njëra palë kontraktuese është e detyruar t’i transferojë, gjegjësisht t’i paguajë palës tjetër kontraktuese në formën e letrave me vlerë ose mjeteve monetare si rezultat i ekspozimit.

“Çmimi i tregut të letrave me vlerë” paraqet çmimin (të rritur me shumën e interesit të llogaritur të pamaturuar, nëse ai interes nuk përfshihet në çmimin) i caktuar nga burim i njohur përgjithësisht (bursat, tregjet përmes sportelit) për të cilin dy palët kontraktuese janë dakorduar, ose çmimin për të cilin dy palët kontraktuese do të dakordohen reciprokisht.

“Koeficienti i mbulimit” është tregues i raportit ndërmjet çmimit të tregut dhe çmimit të blerjes së letrave me vlerë, ose ndonjë raport tjetër për të cilin palët kontraktuese kanë rënë dakord.

“Shuma minimale e kërkesës së mbulimit” është shuma që mund ta përcaktojnë palët kontraktuese, dhe tejkalimi i të cilave tërheq kërkesë për mbulimin e ekspozimit në transaksionin.

“Ditë pune” është dita ku bëhen pagesat përmes MIPS-it (Sistemi i pagesave ndërbankare të Maqedonisë).

neni 3

Në bazë të kësaj kontrate, njëra palë kontraktuese - shitës është e gatshme të shet letrat me vlerë palës tjetër kontraktuese - blerëse, për të cilën blerësi pajtohet të paguan çmimin blerës të shitësit me detyrim të njëkohshëm, në ndonjë datë të ardhshme të cilat do të bien dakord nga të dyja palët kontraktuese ose në thirrje, blerësi t’ia shet letrat e blera me vlerë ose ekuivalente shitësit, ndërsa për ato letra me vlerë shitësi t’i paguan blerësit paraprakisht çmimin e përcaktuar të riblerjes.

neni 4

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, palët kontraktuese mund të bien dakord në çdo kohë për transaksion në pajtim me nenin 3 të kësaj kontrate, me propozimin e cilësdo palë kontraktuese.

Palët kontraktuese bien dakord t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella për transaksion të caktuar me nënshkrimin e përfundimit të dhënë në shtojcën 1 të Kontratës.

II. PAGESA DHE TRANSFERIMI

neni 5

Transferimi i pronësisë së letrave me vlerë nga shitësi dhe transferimi i mjeteve monetare nga blerësi kryhen njëkohësisht (sipas parimit të "dorëzimi kundrejt pagesës"), sipas kushteve të rënë dakord në përfundim.

Me përjashtim, gjatë lidhjes së transaksioneve me letra me vlerë të huaja, palët kontraktuese bien dakord për rendin e transferimit të mjeteve montare në denarë dhe pronësia e letra me vlerë të huaja.

neni 6

Shitësi garanton se letrat me vlerë, gjegjësisht letrat me vlerë ekuivalente janë ekskluzivisht në pronësi të tij dhe nuk kanë ngarkesë ose të drejta të palëve të treta (mbrojtje nga dëbimi), se letrat me vlerë janë fituar në mënyrë ligjore dhe në lidhje me ato nuk udhëhiqet kontest gjyqësor ose procedurë tjetër para organit kompetent.

neni 7

Në rast se letrat me vlerë që janë objekt i transaksionit janë të shprehura në valutë tjetër, llogaritja e detyrimeve monetare kryhet me zbatimin e kursit valutor aktual të publikuar në listën e kursit të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ose kurs valutor tjetër, në të cilën do të bien dakord të dyja palët.

neni 8

Nëse në çfarëdo date duhet të bëhet pagesë e ndërsjellë në bazë të ndonjë detyrimi sipas kësaj kontrate, palët kontraktuese mund të bien dakord të kompensojnë detyrimet e njëra-tjetrës dhe pala që i detyrohet shumës më të madhe t'i paguajë diferencën që i detyrohet palës tjetër kontraktuese. Palët kontraktuese mund të zbatojnë të njëjtin parim në raport me detyrimet për transferimin e letrave me vlerë që janë reciprokisht të njëjta ose ekuivalente.

III. EKSPOZIMI

neni 9

Palët kontraktuese mund të bien dakord të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella në bazë të ekspozimit në transaksion.

neni 10

Nëse palët kontraktuese dakordohen për përcaktimin e ekspozimit në transaksion, përcaktojnë tregun që do të përdorin gjatë përcaktimit të vlerës së tregut të letrave me vlerë ose, në mungesë të formimit të rregullt të çmimeve të tregut primar ose sekondar, përcaktojnë metodë përkatëse për vlerësimin e letrave me vlerë.

neni 11

Nëse në cilëndo ditë nga data e blerjes deri në datën e riblerjes së një transaksioni të caktuar, çmimi i riblerjes në atë ditë shumëzuar me koeficientin e përcaktuar të mbulimit është më i madh se çmimi aktual i tregut të letrave me vlerë, konsiderohet se ekziston ekspozim i blerësit në shumën e diferencës së llogaritur.

Nëse në cilëndo ditë nga data e blerjes deri në datën e riblerjes së një transaksioni të caktuar, çmimi i riblerjes në atë ditë shumëzuar me koeficientin e përcaktuar të mbulimit është më i vogël se çmimi aktual i tregut të letrave me vlerë, konsiderohet se ekziston ekspozim i shitësit në shumën e diferencës së llogaritur.

neni 12

Nëse ndërmjet palëve kontraktuese në të njëjtën kohë zhvillohen disa transaksione, ekspozimi i njëres palë kontraktuese ndaj palës tjetër kontraktuese llogaritet për çdo transaksion veç e veç.

Pala kontraktuese ekspozimi total i së cilës është më i madh se ekspozimi total i palës tjetër kontraktuese, konsiderohet të jetë e ekspozuar neto në shumën e asaj difference.

neni 13

Pala kontraktuese e cila në çdo moment është e ekspozuar, gjegjësisht neto e ekspozuar ndaj palës tjetër kontraktuese, mund të kërkojë nga pala tjetër mbulim në shumë që është e barabartë me atë ekspozim, gjegjësisht ekspozim neto.

Nëse palët kontraktuese kanë përcaktuar shumë minimale të kërkesës për mbulim, kërkesa për mbulim mund të referohet vetëm nëse ekspozimi, gjegjësisht ekspozimi neto, të tejkalon shumën minimale të dakorduar.

neni 14

Në kontratë ndërmjet palëve kontraktuese, mbulimi mund të paguhet në para, gjegjësisht të transferohet në letra me vlerë.

Pagesa e mbulimit në para nga njëra palë kontraktuese ndaj palës tjetër kontraktuese rrit detyrimin e palës tjetër kontraktuese. Ai detyrim merret parasysht gjatë shlyerjes së detyrimeve dhe kërkesave të ndërsjella të palëve kontraktuese në datën e riblerjes, nëse nuk përmbushet përpara datës së riblerjes. Detyrimi rritet për shumën e interesit të llogaritur me zbatimin e normës repo të interesit dhe atë nga dita e pagesës së mbulimit në para deri në ditën në kthimin e tij ose deri në datën e riblerjes.

Transferimi i mbulimit në letra me vlerë nga njëra palë kontraktuese ndaj palës tjetër kontraktuese rrit detyrimin e palës tjetër kontraktuese. Letrat me vlerë merren parasysht gjatë shlyerjes së detyrimeve dhe kërkesave të ndërsjella të palëve kontraktuese në datën e riblerjes, nëse nuk janë kthyer përpara datës së riblerjes.

neni 15

Kur lind detyrimi, në pajtim me nenin 13 të kësaj kontrate, mbulimi paguhet, gjegjësisht transferohet në kuadër të afateve të përcaktuara me përfundimin që është në shtojcë të kësaj kontrate. Nëse afatet për pagesë dhe transferim të mbulimit nuk janë të përcaktuara, mbulimi dorëzohet të njëjtën ditë kur do të përcaktohet ekspozimi, gjegjësisht ekspozimi neto.

Nëse pala që është e detyruar të paguajë mbulimin nuk e bën këtë, ajo është e detyruar të paguajë interes të shumës së llogaritur të mbulimit për kohëzgjatjen e ekspozimit, që është dakorduar në pajtim me nenin 23 të kësaj marrëveshje.

IV. TË HYRAT NGA LETRAT ME VLERË

neni 16

Në rast se në bazë të letrave me vlerë që janë objekt i kësaj marrëveshje, në periudhën ndërmjet datës së blerjes dhe datës së riblerjes (për kohëzgjatjen e transaksionit), paguhen të hyrat, blerësi obligohet që në ditën e pagesës së të hyrave, do t'i paguajë shitësit shumë në të njëjtën shumë dhe valutë aq sa arrijnë të hyrat.

neni 17

Nëse blerësi i shet letrat me vlerë të blera për kohëzgjatjen e transaksionit dhe emetuesi paguan të hyrat në pajtim me nenin 16 të kësaj kontrate, blerësi është i detyruar që në ditën e pagesës së të hyrave t'i paguajë shitësit shumën që është e barabartë me të hyrat që ka paguar emetuesi.

Nëse blerësi nuk i ka paguar të hyrat nga neni 16 shitësit, është i detyruar të paguajë interes ndëshkues të dakorduar në pajtim me nenin 23 të kësaj kontrate.

V. ZËVENDËSIMI I LETRAVE ME VLERË

neni 18

Shitësi mund, me kostot e veta dhe me pëlqimin me shkrim të blerësit, t'i zëvendësojë letrat me vlerë të blera për letra me vlerë tjera (letra me vlerë të reja) që, në datën e zëvendësimit të dakorduar në atë mënyrë, kanë vlerë të tregut së paku të barabartë me vlerën e tregut të letrave me vlerë të blera për të cilat janë zëvendësuar.

neni 19

Zëvendësimi zbatohet me transferim të njëkohshëm të letrave të reja me vlerë nga shitësi dhe blerësi dhe të letrave me vlerë të blera nga blerësi dhe shitësi.

Me përjashtim, në rast të zëvendësimit të letrave të huaja me vlerë, transferimi i letrave të reja me vlerë nga shitësi dhe blerësi dhe të letrave me vlerë të blera nga blerësi dhe shitësi mund të mos bëhet njëkohësisht.

neni 20

Zëvendësimi i letrave me vlerë nuk do të konsiderohet si rinovimi transaksionit të cilës i referohet zëvendësimi, as sikur ndodhjetë transaksionit të ri, por transaksioni do të vazhdojë të bëhet në mënyrë të njëjtë si dhe deri atëherë, për që letrat e reja me vlerë do të konsiderohen për letra me vlerë të blera, në vend të letrave me vlerë që zëvendësohen.

VI. SHKELJA E KONTRATËS

neni 21

Shkelja e kontratës ndodh nëse:

- a) pala kontraktuese nuk bën çfarëdo detyrimi në pajtim me këtë kontratë;
- b) pala kontraktuese përcakton se nuk është në gjendje të plotësojë çfarëdolloj detyrimi të përcaktuar me këtë kontratë dhe/ose të përcaktuar me çfarëdolloj transaksioni, që rezulton nga kjo kontratë.

neni 22

Pala kontraktuese që nuk është përgjegjëse për shkeljen e Kontratës, mund ta ndërpret Kontratën, transaksionin konkret ose të gjitha transaksionet që rezultojnë nga kjo kontratë, me raportim paraprak me shkrim të palës tjetër kontraktuese.

Me ndërprerjen e Kontratës, transaksioni konkret ose të gjitha transaksionet që rezultojnë nga kjo kontratë, detyrimet e dy palëve të dakorduara maturojnë menjëherë, ndërsa data e ndërprerjes konsiderohet si datë e riblerjes.

neni 23

Pala kontraktuese që është përgjegjëse për shkeljen e Kontratës është e detyruar për të kompensuar palën tjetër kontraktuese dëmin e përgjithshëm që ka ndodh me shkeljen e Kontratës, së bashku me interesin ndëshkues që kanë dakorduar palët kontraktuese.

neni 24

Nëse në datën e blerjes, shitësi nuk ia transferon letrat me vlerë blerësit, dhe blerësi nuk ia paguan çmimin blerës të shitësit, do të konsiderohet se dy palët kontraktuese janë tërhequr nga transaksioni dhe përfundimi për atë transaksion do të konsiderohet i pavlefshëm.

neni 25

Nëse në datën e riblerjes blerësi nuk ia transferon letrat me vlerë shitësit, shitësi mund të llogarisë shumën e detyrimeve të ndërsjella (netimin) duke përdorur çmimin aktual të tregut të letrave me vlerë ose të blejë letrat me vlerë dhe të konsideron çmimin e tyre, të rritur për kostot e transaksionit, si çmimi i tregut në datën e riblerjes.

Nëse në datën e riblerjes shitësi nuk ia paguan çmimin e riblerjes të blerësit, blerësi mund t'i mbajë letrat me vlerë dhe të llogarisë shumën e detyrimeve të ndërsjella (netimin) duke përdorur çmimin aktual të tregut të letrave me vlerë ose t'i shes letrat me vlerë dhe të konsideron çmimin shitës, të rritur për kostot e transaksionit, si çmimi i tregut në datën e riblerjes.

Pala kontraktuese, e cila ka borxh më të madh në bazë të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, është e detyruar që diferencën e llogaritur t'ia paguajë palës tjetër kontraktuese në datën e riblerjes.

Në rast se nuk ekziston mundësi për të blerë ose shitur letrat me vlerë ose nuk ekziston çmim aktual të tregut në tregun primar ose sekondar, blerësi mund t'i mbajë letrat me vlerë të aplikuara, dhe shitësi mund t'i mbajë mjetet monetare pa llogaritur detyrimet e ndërsjella (netimin).

neni 26

Nëse në datën e blerjes/datën e riblerjes vetëm njëra nga palët kontraktuese kryen detyrimet e Kontratës, pala tjetër kontraktuese është e detyruar t'i kthejë mjetet monetare të pranuar ose letrat me vlerë së bashku me të gjitha të hyrat nga letrat me vlerë dhe interesin ndëshkues, të dakorduar në pajtim me nenin 23 të kësaj kontrate, të llogaritur mbi çmimin e blerjes/çmimin e riblerjes për periudhën nga data e blerjes/datën e riblerjes deri në datën e kthimit.

neni 27

Në rast të shkeljes së Kontratës në bazë të nenit 17 paragrafi 2, shitësi mund të llogarisë çmim të ri riblerje në datën e riblerjes, të reduktuar me të hyrat që blerësi nuk i ka paguar shitësit në datën e pagesës nga emetuesi i letrave me vlerë dhe

interesi ndëshkues i kësaj shume, të dakorduar në pajtim me nenin 23 të kësaj kontrate.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

neni 28

Të gjitha raportimet që dërgohen në bazë të kësaj kontrate janë me shkrim (me postë, telefaks ose ndonjë mënyrë tjetër të dërgesave elektronike për të cilat janë dakorduar palët kontraktuese), dhe adresa në të cilën dërgohen është përcaktuar më parë nga pranuesi i raportimit.

Raportimi nga paragrafi 1 të këtij neni konsiderohet i vlefshëm:

- a) nëse është në formë të shkruar dhe është dërguar me postë të rekomanduar me vërtetim kthyes për pranim, ose nëse mesazhi i është dërguar pranuesit në dorë, kur pranuesi e ka pranuar mesazhin;
- b) nëse është dërguar me telefaks, kur dërguesi do të merr përgjigje se pranuesi ka pranuar raportimin;
- c) nëse është dërguar në formë elektronike, kur dërguesi do të merr përgjigje se pranuesi ka marr mesazhin elektronik;
- ç) ditën e parë pasuese të punës, nëse është pranuar në ditë jopune.

neni 29

Çdo palë kontraktuese është e detyruar menjëherë ta njoftojë palën tjetër kontraktuese për të gjitha statuset dhe ndryshimet e tjera që lidhen me punën e tij, përfshirë edhe për ndryshimet e adresës, numrin e telefaksit ose të dhëna të përcaktuara me dërgesën e mesazheve në formë elektronike.

neni 30

Të drejtat dhe detyrimet e blerësit dhe shitësit nga kjo kontratë nuk janë të transferueshme dhe blerësi, gjegjësisht shitësi nuk mund t'ua transferojnë personave të tretë.

neni 31

Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj, me afat vlefshmërie me kohë të pacaktuar.

Kjo kontratë mund të ndërpritet me pëlqim të dy palëve kontraktuese me kushte të parashikuara në Kontratën.

neni 32

Me ndërprerjen e Kontratës, llogariten detyrimet e dy palëve kontraktuese, me çka data e riblerjes është data e ndërprerjes së Kontratës.

neni 33

Në rastin e falimentimit vlejnë dispozitat nga Ligji i Falimentimit.

neni 34

Për çdo gjë që nuk është paraparë me këtë kontratë vlejnë dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet Obligative, Ligjit për Letrat me Vlerë dhe rregulloret tjera ligjore në fuqi.

neni 35

Palët kontraktuese do të zgjedhin çdo kontest që rezulton me këtë kontratë krahasuar, dhe në të kundërtën kompetent është Gjykata Themelore Shkupi 2 Shkup.

neni 36

Kjo kontratë është lidhur në 4 (katër) kopje identike, nga dy 2 (dy) kopje për secilën palë kontraktuese.

Pala kontraktuese

Pala kontraktuese

Shtojca 1

PËRFUNDIMI nr. _____

1. Pala kontraktuese - blerësi

Emri dhe Adresa: _____

Llogaria në bankë: _____

Llogaria e letrave me vlerë: _____

2. Pala kontraktuese - shitësi

Emri dhe Adresa: _____

Llogaria në bankë: _____

Llogaria e letrave me vlerë: _____

3. Data e blerjes: _____

4. Data e riblerjes

a) data _____

b) në thirrje

5. Shenja e letrave me vlerë: _____

6. Shuma nominale e letrave me vlerë: _____

7. Çmimi i blerjes: _____

8. Shuma monetare e datës së blerjes: _____

9. Çmimi i riblerjes: _____

10. Shuma monetare e datës së riblerjes: _____

11. Norma repo e interesit: _____%

12. Koeficienti i mbulimit a)

po _____

b) jo

13. Tregu për caktimin e vlerës së tregut gjatë përcaktimit të ekspozimit:

a) tregu: _____

b) çmimi i tregut është i barabartë me çmimin e riblerjes

Në rast të palëve për përcaktimin e koeficientit të mbulimit në pikën 12, duhet ta plotësojnë edhe pikën 13.

14. Afati për transferim (pagesë) të mbulimit: _____

15. Shuma minimale e kërkesës për mbulim: a)

po, shuma minimale: _____

b) jo

16. Forma e lejuar e mbulimit:

a) mbulimi në para

b) mbulimi në letra me vlerë

17. Kursi valutor i dakorduar për vlerësimin në denarë të letrave me vlerë në valutë të huaj dhe letrave me vlerë me klauzolë valutore: _____

18. Interesi ndëshkues i dakorduar në pajtim me nenin 23 të kësaj kontrate:
_____ %

19. Dispozita tjera:

20. Me nënshkrimin e këtij përfundimi, palët kontraktuese obligohen që ky transaksion të bëhet në pajtim me dispozitat nga Kontrata e përgjithshme repo.

Data: _____

Data: _____

Pala kontraktuese - blerësi:

Pala kontraktuese - shitësi: